



Datë: 14.03.2025
Numër Protokolli: 2000/2025

A.nr.82/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.82/2025 të datës 14.01.2025 të parashtruar nga ankuesit I.K. dhe A.H., kundër organit të punësimit/Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 14.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.82/2025 e datës 14.01.2025, e parashtruar nga ankuesit I.K. dhe A.H.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil, I.K. dhe A.H. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit), të punësuar në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, më datë 14.01.2025 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 148/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.82/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vazhdimit të mandatit të Zëvendësuesit të Udhëheqësit Ekzekutiv në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesit me datë 14.01.2025 është **e palejuar**, sepse:

Kolegji i Këshillit, bazuar në shkresat e lëndës konstaton se ankuesit janë të punësuar në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore (në tekstin e mëtejme referuar: KKTK), gjegjësisht ankuesi I.K sipas Akt emërimit AE.Nr.01/2022 të datës 03.08.2022, mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit Programit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, Materiale*, ndërsa ankuesi A.H sipas Akt emërimit AE.nr.02/2021 të datës 07.04.2021 mbanë pozitën e punës të *Udhëheqës i Divizionit Programit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore të Luajtshme*.

Ankuesit, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër organit përkatës të punësimit, me pretendimin ankimor se vazhdimi i ushtrimit të pozitës së punës Zëvendësuesit të Udhëheqësit Ekzekutiv të KKT-së, nga z. K.B sipas Vendimit të datës 13.09.2021, është në kundërshtim me dispozitat ligjore të cilat rregullojnë caktimin e ushtruesit të detyrës, përkatësisht nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, duke theksuar ndër të tjera se gjdo

vendim i marrë nga i njëjti pas datës 18.09.2024 është i paligjshëm apo në kundërshtim me këto dispozita ligjore sepse i njëjti këtë pozitë e ushtron për më shumë se 3 vite e 4 muaj, dhe si për rrjedhojë kanë kërkuar që Këshillit të aprovoj plotësisht ankesën e tyre si të bazuar, të anuloj ose shfuqizoj Vendimin e datës 13.09.2021, mbi të cilin është caktuar Zëvendësuesi i Udhëheqësit të KKTK-së si dhe të obligojë bordin që të caktoj një zyrtar tjetër që i plotëson kriteret sipas paragrafit 2 të nenit 35 të këtij ligji, apo në këtë rast sipas strukturës organizative të organit përkatës të punësimit të caktojë njërin nga ankuesit.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se *“Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t’i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”*, si dhe nenit 124 paragrafi 1 të të njëjtut ligj me të cilin parashihet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim*, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore, Kolegji i Këshillit, konstaton se organi përkatës i punësimit në rastin konkret, ankuesve nuk i ka cënuar ndonjë të drejtë apo interes juridik lidhur me marrëdhënien e tyre të punës, andaj rrjedhë se të njëjtut nuk kanë legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative, dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës ankesa A.nr.82/2025 është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ndërlidhur me nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Mirëpo, përtej asaj që është theksuar me lart e në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor, në kontekst të mbikëqyrës së zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, Kolegji i Këshillit thekson faktin se në situatat e rastit konkret, dhe me qëllim të evitimit të shkeljeve ligjore që mund të krijojnë pasoja juridike organi i punësimit është i detyruar të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin në përpikëri të nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.82/2025, datë 14.03.2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar, ankuesit I.K.;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore dhe KKTK-së; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.